

UDHA ISLAMIE

Viti XIII - Nr. 1 (143), Janar, 2015

E përmuajshme Informative - Fetare - Kulturore - Edukative

Botim i Myftinisë Shkodër

MUHAMMEDI (A.S) MË I MIRI I TË GJITHA KRIJESAVE

"O Muhammed!
Më vjen keq që s'isha
bashkëkohësi yt.

Ky libër, mësues
dhe përhapës i të cilit je ti,
s'është libëriyt. Ai është libërhyjnor.

Të mohosh burimin e tij
është aq qesharake,
sa edhe të pretendosh
pasaktësinë e shkencave e zakte.

Prandaj njerëzimi, vetëm një herë,
kaparënjë figurë të tillë unikale,

SIÇ ISHE TI

Dhe më s'do të ketë rastin
të shohë të ngjashëm.

Unë, me respektin më të madh,
për ulem, para paraqitjes tënde
të madhërishme.

Princi Otto Von Bismark
(1815 – 1898)



MUHAMMEDI (A.S)

MË I MIRI I TË GJITHA KRIJESAVE



Ajni Sinani

Studiues islam, Prizren

Më 12 Rebiul-evvel ditën e hënë, nga nëna Emine dhe babai Abdullah, lindi Muhammedi (a.s), i cili e nderoi botën. Koha më e vlefshme dhe më e rëndësishme, që nga krijimi i gjithësisë e deri në shkatërrimin e saj, padyshim është koha e ardhjes në botë e Pejgamberit të fundit, Muhamedit (a.s). Ky njeri analfabet, pas shpalljes filloi të flas me të folurit më elokuent, me të cilin i habiti dhe i befasoi të gjithë njerëzit.

Populli i tij, ia ofroi sundimin dhe gjithë pasuritë e vendit, vetëm e vetëm që të tërhiqej nga thirrja në fenë Islame dhe përhapja e misionit të vet. Por, ai i refuzoi gjithë këto oferta, dhe në vend të tyre zgjodhi më të vështirën, për hir të misionit të besuar nga Allahu i Madhërishëm. Pejgamberi (a.s) në ditën e çlirimit të Mekkes, hyri me një modesti të madhe, i hipur mbi deve, me kokë të përulur përpara sikur bënte sexhde, duke iu falenderuar Allahut të Madhërishëm.

Muhammedi (a.s) është një krijesë e përsosur dhe shembulli më i përkryer për mbarë njerëzimin. Drita që erdhi në shkretëtirë, rrezatoi anembanë rruzullit tokësor.

Kur hyri në Mekke ua fali mekkasve të gjitha meritë duke u thënë: “Edhe unë, ashtu sikurse u tha Jusufi vëlle-

*“Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiu i tyre të dërguar
që t’u lexojë atyre ajetet e Tua,
t’u mësojë atyre librin dhe urtësinë,
e t’i pastrojë (prej ndyrësisë së idhujtarisë) ata.
S’ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijshti.”
(El-Bekare: 129)*

zërve të vet, po ju them: “Sot nuk ka qortim kundër jush, Allahu ju faltë juve; Ai është më mëshiruesi i mëshiruesve!” (Jusuf: 92) Shkoni jeni të lirë!”

Kur i Dërguari i Allahut kishte shkuar në Taif, për ta thirrur popullin e Taift në fenë islame, ata e gjuajtën me gurë. Xhebraili (a.s) i thotë Muhammedit (a.s): “A ta shkatërroj këtë popull, duke i bashkuar këto dy bjeshkë njëra me tjetrën”? Pejgamberi (a.s), përkundrazi lutet duke thënë: “O Zoti Im! Sille në rrugë të vërtetë këtë popull. Unë shpresoj që nga këta të dalë një brez besimtarësh.”

Kur ishte kërkuar nga i dashuri i Allahut që të mallkojë, ai kishte thënë: “Unë nuk jam dërguar për të mallkuar. Unë jam pejgamber i mëshirës.”

Dhe vërtet dërgimi i Muhammedit (a.s) është një mëshirë e madhe nga ana e Allahut për të gjitha botërat.

DISA CILËSI TË MUHAMMEDIT (A.S) TË PËRMENDURA NË KUR’AN

1. Allahu e ka përmendur emrin e tij të nderuar së bashku me emrin e Vet, në pafillshmërinë e amshuar dhe e ka qëndisur në Levhi Mahfudh duke e shkruar atë mbi Arsh, mbi kopshtet e Parajsës dhe mbi shtatë qiejt: “La ilahe il’l-Allah, Muhammedun Resulullah.”

2. Zoti e lartësoi përmendjen e emrit të tij përkrah emrit të Vet në

Fjalën e Dëshmisë, në ezan, në ikamet, në teshehudin e namazit, në shumë lutje, në shumë vepra adhurimi, në hutbe, në varr, në Ditën e Gjykimit, në Parajsë dhe në gjuhët e folura prej të gjithë krijesave: “Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënd.” (El-Inshirah: 4)

3. Zoti shpëtimin e madh e lidhi me nënshtrimin ndaj Tij dhe të Dërguarit (a.s) të Tij: “Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ka arritur një shpëtim të madh!” (El-Ahzab: 71)

4. Zoti betohet se Muhammedi (a.s) nuk kishte humbur rrugën dhe as që kishte devijuar: “Shoku juaj (Muhammedi (a.s) as nuk është njeri që ka humbur, as që ka devijuar.” (En-Nexhm: 2)

5. Zoti ia mbrojti zemrën nga rreziqet dhe blasfemia: “A e ke parë ti atë, që për zot e merr epshin e vet, a mos ti do t’i bëhesh atij dorëzanës?” (El-Furkan: 43)

6. Zoti dhe engjëjt i çojnë selame: “Eshtë ë vërtetë se Allahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhëroni pra atë (duke rënë sala-vatë) dhe përshëndeteni me selam.” (El-Ahzab: 56)

7. Zoti ia hapi dhe ia pastroi gjoksin: “A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënd?” (El-Inshirah: 1)

8. Zoti ia hoqi barrën: “Dhe Ne hoqëm prej teje barrën tënde, e cila shtypte shpinën tënde.” (El-Inshirah: 2-3)

9. Zoti nuk e braktisi dhe as nuk e


JA RESULALLAH, NJERËZIMI SOT KA MË SHUMË NEVOJË PËR TY...

Një ndjesi e veçantë shpirtërore të jesh në Xhaminë e Profetit (a.s), aty ku fjalët gjunjëzohen para ndjenjave. Në ato momente ke ndjesinë e shkëputjes nga ligësitë e kësaj bote, larg rutinës së zakonshme, më afër shpirtërores.

Si mund të ndodhë ndryshe kur je në prezencën shpirtërore të më të Dashurit të zemrave tona, të udhërrëfyesit të njerëzimit, të dritës së pashuar, që ndriçoi zemrat dhe mendjet tona, tek ai që erdhi si mëshirë për mbarë botët, tek ai që ishte shembulli më i lartë i moralit që kishte parë dhe do shikonte njerëzimi...

Keqardhje për të gjithë ata njerëz që nuk e kuptuan siç duhet mesazhin hyjnor që solli ai.

Keqardhje për të gjithë ata njerëz të vegjël që me veprimet e tyre jo të hijshme pretendojnë se mund të vënë hije mbi personalitetin e tij.



Ai është si dielli për të gjithë myslimanët, dhe siç nuk mund ta shuajnë dritën e diellit me frymë, ashtu s'mund ta shuajnë respektin dhe dashurinë që myslimanet kanë për të.

Ja Resulallah! Njerëzimi sot ka më shumë nevojë për ty, për mesazhin tënd, për shembullin tënd.

Allahu na bëftë prej ndjekësve të sinqertë të traditës tënde, prej ume-tit tënd të nderuar dhe të denjë për shefatin (ndërmjetësimin) tënd në Ditën e Gjykimit!

Amin...

Skender Bruçaj

*Kryetar i KMSH
Medine, 12 janar 2015*

përbuzi: “Zoti yt as nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur.” (Ed-Duha: 3)

10. Botën e amshueshme ia bëri shumë më të mirë se kjo botë:

“Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para.” (Ed-Duha: 4)

11. Zoti i dha dhe e bëri të kënaqur: “E Zoti yt do të japë ty, e ti do të kënaqesh.” (Ed-Duha: 5)

12. Zoti e strehoi dhe e mbrojti: “A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të dha strehë.” (Ed-Duha: 6)

13. Zoti e udhëzoi atë: “Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të udhëzoi.” (Ed-Duha: 7).

14. Zoti e pasuroi dhe begatoi: “Dhe të gjeti të varfër e të pasuroi.” (Ed-Duha: 8)

15. Zoti ia dha Keutherin: “Ne, vërtet të dhamë ty shumë të mira (Kevtherin).” (El-Kevther: 1)

16. Zoti ia pastroi gjuhën: “Ai nuk flet nga hamendja.” (En-Nexhm: 3)

17. Zoti ai pastroi zemrën: “Zemra

nuk e përgënjeshtroi atë që pa.” (En-Nexhm: 11)

18. Zoti ia pastroi memorjen/mbamendjen: “Ne do ta lexojmë ty e nuk do ta harrosh (Kur’anin).” (El-Ala: 6)

19. Zoti ia pastroi të dëgjuarit: “Dhe veni veshin thirrësit kur thërret nga ndonjë vend i afërt.” (Kaf: 41).

20. Zoti ia pastroi të pamurit: “Shikimi (i Muhammedit (a.s) as nuk lakoi as nuk tejkaloi.” (En-Nexhm: 17)

21. Zoti ia pastroi namazin, qëndrimin në këmbë dhe rënien në sexhde: “I Cili të sheh kur të ngrihesh në këmbë. (E sheh) Edhe lëvizjen tënde në mesin e atyre që falen.” (Esh-Shuara: 218-219).

22. Zoti ai ka pastrue lutjen: “Dhe lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta.” (Et-Teobe: 103).

23. Zoti e barti nga Meka në Kuds (Isra): “Pa të meta është Lartmadhëria e Tij që ë kaloi robin e Vet në një pjesë të natës prej Mesxhidi Hara-

mit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa...” (El-Isra: 1)

24. Zoti e ngriti nga Kudsi deri mbi shtatë qiejt (miraxh), tek Sidretul Munteha: “Tek Sidretul Munteha. Që pranë saj është xhennetull Me’va.” (En-Nexhm: 14-15)

25. Zoti i tregoi gjëra të jashtëzakonshme gjatë miraxhit: “Ai vërtet, pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet.” (En-Nexhm: 18)

26. Zoti ia fali mëkatet: “Ashtu që Allahu të liroi ty prej mëkateve të mëparshme dhe prej atyre të mëvonshme...” (El-Fet'h: 3)

27. Zoti është betuar në jetën e tij: “Pasha jetën tënde (Muhammed) s’ka dyshim se ata ishin të humbur në dehjen e tyre.” (El-Hixhr: 72) .

28. Zoti nuk i drejtohet me emër por me thirrjen: “O i dërguar”: “O ti i dërguar! Komunikoj atë që t’u zbrit prej Zotit tënd...” (El-Maide: 67).

29. Zoti e pastroi moralin e tij: “Vërtet, ti je në një shkallë të lartë

të moralit.” (El-Kalem: 4)

30. Zoti betohet se ai nuk është i marrë: “Nuk është i marrë shoku juaj (Muhammedi).” (Et-Tekvir: 22)

31. Zoti e dërgoi atë që t’ia lexonte njerëzve ajetet e Kur’anit dhe t’i pastronte ata nga idhujtaria dhe mosbesimi: “Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t’iu lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë librin dhe sheriatin...” (El-Xhumua: 2)

32. Zoti e bëri shembull për njerëzimin: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin ë All-llahut...” (El-Ahzab: 21)

33. Zoti e dërgoi për të gjithë njerëzit dhe xhindet (Resulu Thekalejn):

“Thuaj: Mua më është shpallur se një grup nga xhinët i vuri veshin dhe dëgjoi (Kur’anin) dhe thanë: Ne kemi dëgjuar një Kur’an që mahnit, që udhëzon në të vërtetën, andaj ne i besuam atij dhe Zotit tonë, kurrse si nuk do t’ia shoqërojmë më askënd.” (El-Xhinn: 1-2)

34. Zoti e dërgoi dëshmuar, lajmëtar, përgëzues, qortues, sihariq-dhënës dhe pishtar ndriçues: “O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmuar, lajmëtar, përgëzues e qortues. Dhe me urdhrin e Allahut, thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtar ndriçues. E besimtarëve jepi sihariq se prej Allahut ata kanë dhunti të madhe.” (El-Ahzab: 45-47).

35. Zoti e dërgoi mëshirë për të gjitha botët dhe të gjitha krijesat: “E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” (El-Enbija: 107).

36. Zoti e cilëson me cilësitë specifike “Reuf” (i Butë) dhe “Rahim” (i Mëshirshëm): “Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm-butë dhe i mëshirshëm për besimtarët.” (Et-Teobe: 128).

37. Pejgamberit (a.s) i vinte keq edhe për pabesimtarët: “A thua ti, do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij

ligjërimi (Kur’anit)?” (El-Kehf: 6).

38. Zoti e dërgoi Muhammedin (a.s) që t’i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë: “... për t’i nxjerrë ata që besuan dhe bënë vepra të mira prej errësirave në dritë...” (Et-Talak: 11)

39. Dërgimi i tij ishte dhuratë e madhe për besimtarët: “Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta, nga mesi i tyre dërgoi të dërguar...” (Ali Imran: 164)

40. Zoti dëshmon për misionin e tij: “O ju njerëz, juve ju erdhi i dërguari me të vërtetën nga Zoti juaj...” (En-Nisa: 170)

41. Isai (a.s) kishte lajmëruar ardhjen e tij, (madje sipas sunnnetit të gjithë pejgamberët e kanë bërë një gjë të tillë): “*Dhe, kur Isai, bir i Merjemes tha: ...dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed....*” (Es-Saff: 6)

42. Zoti ia dha Kur’anin: “Dhe poashtu Ne ta zbritëm ty librin...” (El-Ankebut: 47); “Ne nuk ta shpallëm Kur’anin për të të munduar.” (TA HA: 2)

43. Zoti e bëri të Dërguarin, pejgamer të fundit: “Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve...” (El-Ahzab: 40)

44. Gratë e Pejgamberit (a.s) janë nënat e besimtarëve: “Ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre.” (El-Ahzab: 6)

SIPAS SUNNETIT

“Allahu i Madhëruar mua më ka dërguar për ta plotësuar moralin e bukur.”

“Mos u frikëso vëllai im! Qetësohu! Unë nuk jam as mbret e as perandor. Jam bonjaku i fqinjit tënd të vjetër që ka ngrënë mish të tharë në diell!”

Omerit i ishin mbushur sytë me lot, kur kishte parë që i Dërguari i Allahut jetonte mbi një shtrojë të thatë, ndërkaq Kajseri dhe Kisrau notonin në begati. Pejgamberi (a.s) për ta qetësuar Hz. Omerin i thotë:

Një i ri e pyeti
Shejkh Muhammed
Gazaliun:

Hoxhë, çfarë
vendimi ka
për një të ri
që nuk e fal
namazin?

Hoxha ia ktheu:
"Vendimi është:
Merre me vete
dhe sille
në xhami!"

MORALI:

*Bëhu thirrës
drejt të mirës,
jo gjykatës!*

“O Omer! Kisrau dhe Kajseri le të i marrin begatitë e kësaj bote, le të jetojnë me to. Neve na mjafton begatia e botës tjetër!”

H.z. Muhammedi (a.s) është “i dashuri i Allahut” (habibullah), i parapëlqyeri ndër pejgamberët dhe më i nderuari i gjithë krijesave. Ai është i Dërguari i kohës së fundit, “i fundit i pejgamberëve” (hatemul enbijai vel murselin). Pejgamberit të mëshirës i janë dhuruar, për Ditën e Kijametit, pozitat e “të përzgjedhurit” (mahmud; mekami mahmud) dhe e “ndërmjetësuesit të madh për falje” (shefaatu udhma). Ai netët i kalonte duke u falur, aq sa këmbët i ënjteshin. Kur H.z. Aisheja i tha se pse lutej aq gjatë natën, ndërkaq që Allahu ia kishte falur mëkatet e mëparshme dhe të mëpasme, ia i ishte përgjegjur duke thënë: “A nuk duhet të jem rob mirënjohës dhe falenderues ndaj Allahut?” Ai ishte i dashur dhe i besueshëm tek populli i tij. Atë e quanin el Emin (Besnik) dhe es Sadik (i Besueshmi). Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Unë jam Muhammed dhe Ahmed. Unë jam Asgjësuesi (Mahi), me pejgamberinë time Allahu do ta asgjësojë mohimin. Unë jam Bashkuesi (Hashir), rreth të cilit do të tubohen dhe mbliidhen njerëzit në Ditën e Ringjalljes. Unë jam vula e pejgamberëve (Hatemul Enbija), dhe Përmbyllësi (Akib), pas meje s’do të ketë pejgamber tjetër.”

Pejgamberi (a.s) gjithashtu thotë: “Allahu i Madhërishëm, ndër bijtë e Ibrahimit, zgjodhi Ismailin. Nga bijtë e Ismailit zgjodhi bijtë Kinane. Nga bijtë Kinane zgjodhi Kurejshët. Nga Kurejshët zgjodhi bijtë Hashim. Nga bijtë Hashim zgjodhi bijtë Abdulmutalib. Dhe nga bijtë Abdulmutalib, më zgjodhi mua.”

Nëna Emine në ditët e para të shtatzënisë, pa një ëndërr. Asaj iu tha: “Ti je shtatzënë në më të mirin e këtij ummeti. Kur ta lindësh atë, lute duke thënë: Mbështetem te Allahu nga sherri i çdo të keqi.” Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Unë jam lutja e gjyshit tim, Ibrahimit, sihariqi i vëllait tim, Isait dhe ëndrra e nënë sime.”

CILËSITË DHE SHPREHITË E BUKURA MORALE TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

- I Dërguari (a.s) ishte më superior ndaj të gjithë pejgamberëve të tjerë: në dije, në njohje, në të kuptuar, në intelekt, në mprehtësi, në siguri, në njohje të sigurt, në zgjuarsë, në kapacitetin mendor, në zemërgjerësi, në modesti, në dhembshuri, në butësi, përkorje, në ndjeshmëri, në durim, në entuziazëm, në atdhetari, në devotshmëri, në besueshmëri, në kurajo, në madhështi, në trimëri, në elokuencë, në retorikë, në guxim, në bukuri, në të shmangurit ndaj kënaqësive të jetës tokësore, në dëlirësi, në shpirtmirësi, në ndershmëri, në frikë-respekt. Ai i falte njerëzit e tjerë për sjelljet e tyre keqdashëse ndaj tij, si shokët, edhe armiqtë e tij po ashtu. Ai kurrë nuk hakmerrej kundrejt tyre. Kur ata bënë që nga faqa e tij e bekuar të rrjedhë gjak dhe thyen dhëmbin e tij të bekuar gjatë luftës së shenjtë në Uhud, ai shqiptoi bekimin e mëposhtëm rreth njerëzve, të cilët i shkaktuan atij këto dëmtime: “O Zot fali ata për padijen e tyre.”

- Ai ishte jashtëzakonisht i dhembshëm, ai u jepte kafshëve ujë për të pirë. Ai mbante në duart e tij enën derisa kafshët ngopeshin. Ai pastronte papastërtitë prej kalit që përdorte.

- Kur njerëzit e thërrisnin atë, kushdo qofshin ata, ai u përgjigjej, ‘Leb-bejk’- ‘Po zotëri’.

- Ai kurrë nuk i shtrinte këmbët kur ishte në shoqëri me të tjerët. Ai ulej mbi gjunjët e tij. Sa herë që ai shihte një këmbësor, ndërsa ia ishte i hipur mbi një kafshë, ai e lejonte këtë person të ulej mbrapa tij, mbi kafshë.

- Ai nuk e nënvlerësonte askënd. Gjatë një ekspedite, një prej shokëve të tij mori për sipër të therte një dele, që ta hanin. Një tjetër mori mbi vete ta rripte, dhe një tjetër tha se do ta gatuante. Kur i Dërguari (a.s) tha se ai do të siguronte drutë për zjarr, ata thanë: “O i Dërguari i Allahut, të lutemi të ulesh dhe të pushosh, ne do

“O I DËRGUARI I ALLAHUT,
TË LUTEMI TË ULESH
DHE TË PUSHOSH, NE DO
T’I SIGUROJMË GJITHASHTU
EDHE DRUTË PËR ZJARR!”
PEJGAMBERI I BEKUAR THA:
“PO, JU DO T’I BËNI KËTO.
UNË E DI SE JU DËSHIRONI
T’I BËNI TË GJITHA PUNËT,
POR MUA NUK MË PËLQEN
TË QËNDROJ ME NJË ANË,
DHE TË ULEM,
NDËRSA TË TJERËT
JANË DUKE PUNUAR.
ALLAHU I MADHËRISHËM,
NUK E PËLQEN NJË PERSON,
I CILI QËNDRON VEÇAN
PREJ SHOKËVE TË TIJ.”

t’i sigurojmë gjithashtu edhe drutë për zjarr!” Pejgamberi i bekuar tha: “Po, ju do t’i bëni këto. Unë e di se ju dëshironi t’i bëni të gjitha punët, por mua nuk më pëlqen të qëndroj me një anë, dhe të ulem, ndërsa të tjerët janë duke punuar. Allahu i Madhërishëm, nuk e pëlqen një person, i cili qëndron veçan prej shokëve të tij.” Ai u ngrit dhe vazhdoi rrugën për të gjetur drutë e zjarrit.

- Kurdoherë që ai i bashkohej një grupi sahabësh të ulur së bashku, ai kurrë nuk zinte vendin më të dukshëm. Ai ulej në vendin e parë të pazënë që vërente. Një ditë ai doli me shkopin e tij në dorë, me të cilin ecte. Njerëzit që e panë u ngritën në këmbë. Ai i porositi ata: “Mos u ngritni për mua, sikurse disa njerëz, të cilët qëndrojnë në këmbë gatitu për njëri

AI KURRË

NUK KA FOLUR

NDONJË GJË

TË PANEVOJSHME

APO TË PAVLERË.

AI FLISTE PËRMBLEDHTAZI,

KONKRETISHT,

QARTËSISHT

DHE KUR KJO

ISHTE E DOMOSDOSHME.

NDONJËHERË AI

E PËRSËRISTE TË NJËJTËN

SHPALLJE TRE HERË,

NË MËNYRË QË AJO

TË KUPTOHEJ MIRË.

tjetrin. Unë jam njeri, sikurse ju. Unë ha, sikurse çdo person tjetër. Dhe unë ulem, kur jam i lodhur.”

- Ai më së shumti ulej mbi gjunjët e tij. Ai, gjithashtu, transmetohet të jetë parë i ulur këmbëkryq, me krahët e tij rreth gjunjëve të tij. Ai nuk i linte më një anë shërbyesit e tij gjatë aktiviteteve të përditshme, sikurse të ngrënit, të veshurit, etj. Ai u ndihmonte atyre me punë. Ai kurrë nuk është parë të godasë apo të mallkojë ndokënd. Enes Bin Malik, i cili ishte vazhdimisht në shërbim të tij, ka thënë: “Unë i kam shërbyer të Dërguarit të Allahut për 14 vjet. Shërbimi që ai më ka bërë mua, është më tepër se shërbimi që unë i kam bërë atij. Kurrë nuk e kam parë atë të më zemërojë apo të më qortojë mua.”

- Ai ka arnuar dhe rregulluar vetë rrobat e tij, ka mjelë delen e tij dhe ka ushqyer kafshët e tij. Ai ka bartur vetë sendet e blera në pazar për shtëpinë e tij. Kur udhëtonte ai i ushqente kafshët e tij, ndonjëherë, ai madje i pastronte ato. Ndonjëherë

ai i bënte këto shërbime vetë, dhe ndonjëherë i ndihmonte shërbyesit e tij për t'i bërë ato.

-Kur disa njerëz dërgonin shërbyesit e tyre tek ai, ai shkonte me shërbëtorët duke ecur dorë për dorë, siç ishte zakoni në Medinë. Ai u kushkonte vëmendje vizitave tek njerëzit e sëmure dhe i shoqëronte xhenazet. Me qëllim që të paqësonte mosbesimtarët dhe hipokritët, ai vizitonte gjithashtu të afërmit e tyre të shtrirë në shtrat.

-Pasi udhëhiqte namazin e mëngjesit në xhami, ai pyeste: “A është ndonjë prej vëllezërve të sëmure në shtëpi? (Nëse ishte ndonjë) Le t'i vizitojmë ata.” Kur ndodhte të mos ishte asnjë i sëmure, ai pyeste: “A është ndonjë familje që ka nevojë për t'u ndihmuar për varrim? Le të shkojmë dhe t'i ndihmojmë atyre.” Nëse kishte ndonjë varrim, ai ndihmonte në larjen dhe mbështjelljen me qefin të kufomës, në udhëheqjen e namazit të xhenazës dhe ecte me xhemat për në varr. Kur nuk kishte ndonjë varrim, ai thoshte nëse ju keni ndonjë ëndërr për të interpretuar, unë do ta bëjë këtë. “Më lejoni ta dëgjoj dhe ta interpretoj atë.”

- Kur ai nuk e shihte ndonjë prej sahabëve të tij për tre ditë rresht, ai interesohej për shëndetin e tij. Nëse sahabiu ishte në udhëtim, ai drejtonte lutje bekimi për të. Nëse i thuhej se sahabi ishte në qytet, ai e nderonte atë më vizitë. Kur ai e takonte ndonjë musliman gjatë rrugës së tij, ai e paraprinte atë në selam. Ai udhëtonte mbi deve, kalë, mushkë, apo gomar dhe shpesh here, ai kishte dikë tjetër të ulur mbrapa tij, mbi kafshë.

- Ai ju shërbente mysafirëve dhe sahabëve të tij dhe thoshte: “Zotëriu dhe anëtar i fisnik i bashkësisë është ai që ju shërben atyre.” Ai kurrë nuk është parë në shpërthim të buzëqeshjes. Ai vetëm bënte buzëqeshje të pazëshme dhe kur qeshte shiheshin dhëmbët e bekuar të tij në pjesën e përparme. Ai gjithmonë dukej i kredhur në mendime dhe

serioz, dhe fliste pak. Ai fillonte të fliste me buzëqeshje.

- Ai kurrë nuk ka folur ndonjë gjë të panevojshme apo të pavlerë. Ai fliste përmbledhtazi, konkretisht, qartësisht dhe kur kjo ishte e domosdoshme. Ndonjëherë ai e përsëriste të njëjtën shpallje tre herë, në mënyrë që ajo të kuptohej mirë. Ai bënte shaka me të panjohurit dhe të njohurit, me fëmijët dhe gratë e moshuara dhe me gratë e tij të bekuara. Por këto shaka, kurrë nuk bënë që ai të harronte Allahun e Madhërishëm.

- Ai kishte një pamje që të ngjallte nderim, sa që askush nuk guxonte ta shikonte atë në fytyrë. Një vizitor, i cili e vështroi fytyrën e tij të bekuar, u dërsit. Ai i tha: “Mos u shqetëso! Unë nuk jam mbret dhe nuk jam aspak mizor. Unë jam djali i një gruaje e cila hante mish të tharë.” Këto fjalë ja larguan frikën njeriut dhe ai filloi të thotë atë që dëshiroi.

- Ai nuk ka pasur roje apo njerëz që t'i qëndronin tek dera. Çdo njeri lehtësisht mund të shkonte dhe të bisedonte me të. Ai kishte një ndjenjë të fuqishme modestie. Ai në të vërtetë gjithashtu ishte i druajtur

*AI NUK IA PËRPLASTE
NË FYTYRË ASNJË PERSONI
GABIMIN E TIJ.
AI NUK ANKOHEJ PËR DIKË,
APO NUK BISEDONTE
PRAPA SHPINËS SË DIKUJT.*

për ta shikuar një person në fytyrë. Ai nuk ia përplaste në fytyrë asnjë personi gabimin (të metën) e tij. Ai nuk ankohej për dikë, apo nuk bisedonte prapa shpinës së dikujt. Kur ai nuk i pëlqente disa sjelle apo fjalë të ndokujt, ai thoshte: “Unë habitem, pse disa njerëz veprojnë kështu?!”

- Megjithatë ai ishte më i shtrenjti dhe më i dashuri, dhe i dërguari i zgjedhur i Allahut të Madhërishëm,

ai e kishte zakon të thoshte: “Midis jush unë jam ai, i cili e njeh Allahun e Madhërishëm më së miri dhe i frikësohem atij më së shumti”. Një deklarata tjetër, që ai e kishte shprehur ta thoshte është: “Sikur ju shihnit atë që shoh unë, ju do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë.” Kur ai shihte retë në qiell, e kishte zakon të thoshte: “O Zot, mos na dërgo neve dënim nëpërmjet këtyre reve.” Kurdoherë që frynte erë, ai lutej: “O Zot na dërgo ne era të dobishme.” Kur ai dëgjonte bubullimë, ai lutej: “O Zot mos na dëno me zemërimin Tënd dhe mos na shkatërro me hidhërimin Tënd. Dhe na beko me shëndet të mirë.”

- Kurdoherë që ai kryente namazin, tingujt e të psherëtimës dëgjoheshin prej kraharorit të tij, sikur të ishte dikush duke u ngashëryer brenda. Të njëjtët tinguj dëgjoheshin kur ai lexonte Kur'anin e shenjtë. Zemra e tij ka një forcë të mahnitshme të burrërisë dhe të trimërisë. Gjatë luftës së shenjtë të Hunejnit, muslimanët u shpërndanë me qëllim të mbledhjes së plaçkës së luftës, dhe vetëm tre apo katër njerëz mbetën me të. Pabesimtarët ndërmorën një ofensivë të papritur dhe kolektive. I Dërguari i Allahut u bëri ballë atyre dhe i shpartalloi ata. E njëjta ngjarje ka ndodhur disa herë, ai kurrë nuk tërhiqej.

- I Dërguari (a.s) ishte jashtëzakonisht bujar, ai dhuronte me qindra deve dhe dele, pa mbajtur asnjë kokë të vetme për vete. Shumë pabesimtarë zemërngushtë, i panë me admirim veprat e tij zemërgjera të bamirësisë dhe iu bashkuan besimtarëve.

- Ai nuk është dëgjuar kurrë të thotë ‘jo’ për diçka, që është kërkuar prej tij. Nëse ai e kishte atë e cila i ishte kërkuar atij, ai e jepte atë. Dhe heshtja e tij linte të kuptohej se ai nuk e kishte gjënë që kërkohej.

-Pavarësisht prej ofertës Hyjnore, ku Allahu i Madhërishëm i kishte premtuar: “Më kërko, Unë do të jap.”, ai nuk lutej për pasuri materiale që i përkisnin kësaj bote. Ai kurrë nuk ka ngrënë bukë të bërë prej

miellit të grurit të situr. Ai gjithmonë ka ngrënë bukë të bërë prej miellit të elbit të pasitur. Ai kurrë nuk është parë të hajë derisa të ngopej. Ai hante vetëm bukë dhe ndonjëherë me hurma, me uthull, me fruta, me supë, apo me copa të ngjyra të bukës me vaj ulliri.

- Ai hante mishin e pulës, si edhe mishin e lepurit, devesë, apo antilopës, peshkut, mishin e tharë dhe djathë. Atij i pëlqente të hante (mish) prej këmbëve të përparme të kafshëve. Ai e mbante mishin në duart e tij dhe e hante atë me marrjen e kafshatave. Ai zakonisht pinte qumësht, ose hante hurma. Shpesh, ata nuk gatuanin asgjë, ose nuk bënë bukë për dy ose tre muaj me radhë në shtëpinë e tij. Kështu ai hante vetëm hurma për muaj me radhë. Kishte raste kur ai nuk kishte për të ngrënë asgjë për dy ose tre ditë rresht. Pasi ai vdiq u gjend një çifut, i cili mbante parzmoren e tij si peng, për tridhjetë kilogram elb, të cilat Pejgamberi i bekuar ia kishte borxh atij.

- Ai kurrë nuk është dëgjuar të thotë se nuk e pëlqen një lloj ushqimi të caktuar. Ai e ka ngrënë atë që e ka pëlqyer dhe nuk e ka ngrënë atë ushqim që nuk e ka pëlqyer, por ai nuk ka thënë asgjë. Ai hante njëherë ushqim në ditë. Ndonjëherë ai e hante ushqimin e tij ditor në mëngjes dhe ndonjëherë e hante atë në mbrëmje. Kur ai kthehej në shtëpi, ai thoshte: “A ka diçka për të ngrënë?” Nëse përgjigja ishte negative ai edhe agjëronte. Në vend të vendosjes së ushqimit mbi diçka të ngjashme me mbulesën e tavolinës, tabakasë apo tavolinës, ai e vendoste atë mbi dyshe, e shtronte tek gjunjët e tij dhe e hante pa u mbështetur askund.

- Ai thoshte ‘bismillah’ në fillim dhe pastaj fillonte të hante. Ai hante me dorën e tij të djathtë. Shpesh ai linte mënjane një sasi elbi dhe hurmash, për të mbajtur nëntë gratë e tij dhe një numër të vogël shërbyesish për një vit, duke dhënë një pjesë të kësaj sasive, si sadaka për të varfrit. Mish i deles, lëngu i mishit, kungulli,

"THONË:

"KY ËSHTË AHIRI ZAMANI!"

PSE, KOHA E HZ. JUSUFIT,

ISHTE MË E MIRË?!

THONË:

"ËSHTË MJEDIS I KEQ!"

PSE, MJEDISI I HZ. JUSUFIT,

ISHTE MË I MIRË?!

"RRYMË E PRISHURI!"

PSE, ÇFARË RRYME ISHTE

NË KOHËN E HZ. JUSUFIT?

MUSLIMANI, KUR E SHFAQ

ISLAMIN E TIJ,

ME SINQERITET DHE URTËSI,

TË GJITHA RRYMAT

DO TË MPOSHTEN,

PËRVEÇ RRYMËS SË TIJ!"

- Shejh Ahmed Rreftaro -

ëmbëlsirat, mjalti, hurmat, qumësh-ti, kajmaku, lëngu i pjeprit, pjepri, rrushi, trangujt dhe uji i freskët, ishin llojet e ushqimit që ai i pëlqente veçanërisht. Kur ai pinte ujë, thoshte ‘bismilah’, e pinte me gllënjka të vogla në mënyrë të ngadaltë dhe bënte dy ndërprerje. Ai thoshte ‘elhamdulillah’, pasi pinte.

- Sikurse Pejgamberët e tjerë ai refuzonte që atij t’i jepej sadaka ose zekat. Ai pranonte dhurata, kryesisht të dhëna më tepër si shkëmbim. Çdo pejgamber tjetër e kishte vulën e tij mbi dorën e djathtë, kurse Muhammedi (a.s) e ka pasur mbi lëkurë, në shpatullën e djathtë. Kur Xhebraili e lau zemrën e tij dhe e mbylli në kraharorin e tij, ai vendosi vulën që e kishte sjellë prej parajsës mbi shpinën e tij. Ai shihte atë çka ishte pas tij, njëlloj si edhe atë që ishte para tij. Ai shihte në errësirë, njëlloj sikurse edhe në dritë. Ndërsa sytë e tij të bekuar flinin zemra e tij e bekuar rrinte zgjuar.

- Megjithëse ai kishte një shtat të mesëm, ai dukej më i gjatë se të gjithë njerëzit e gjatë që qëndronin pranë tij. Kur ai ecte në diell, apo në dritën e hënës, hija e tij nuk binte mbi tokë. Kurdoherë që ai ecte engjëjt e ndiqnin nga pas. Ai u thoshte sahabëve të tij të ecnin përpara tij, duke u thënë atyre të linin hapësirë të pazënë “për engjëjt.” Kur ecte mbi rrëzë këmbët e tij nuk linin gjurmë mbrapa.

- Ai është pajisur me të gjitha cilësitë dhe shprehitë e bukura morale që njerëzimi mund të posedojë. Më e larta e superioriteteve të tij, është se ai ishte Habibullah (i Dashuri i Allahut). Allahu i Madhëruar atë e bëri të dashurin e Tij, Ai e donte atë më tepër se çfarëdo personi ose engjëlli tjetër. Në një hadith kudsî Allahu thotë: “Sikurse Unë e bëra Ibrahimin Halil, ashtu Unë e bëra atë (Muhammedin (a.s) Habib të Vetvetes.”

- Zemra e tij e bekuar ishte gjithmonë me Allahun e Madhëruar, natën, kur flinte ashtu edhe kur ishte i zgjuar, kur ishte i shoqëruar ashtu edhe kur ishte vetëm, kur ishte në shtëpi ashtu edhe kur ishte në udhë-

tim, në situata lufte, kur ishte duke qarë ashtu edhe kur ishte i gëzuar. Në të vërtetë, ekzistonin raste kur zemra e tij ishte vetëm me Allahun e Madhëruar. I foluri i tij ishte jash-tëzakonisht i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm. Me pak fjalë ai thoshte shumë.

- Numri i ummetit të Muhammedit (a.s) e tejkalon numrin e gjithë ummeteve të pejgamberëve të tjerë. Pejgamberi i është lutur Allahut që të mos e lejojë ummetin e tij që të pajtohet me konsensus për lajthim. Ai e ka parë Xhibrilin (a.s) në pamjen e tij prej engjëlli dy herë. Bijat dhe gratë e Resulullahit të bekuar janë

*“A E KENI
LEDHATUAR SOT
NDONJË KOKË JETIMI?
A KENI VIZITUAR
NDONJË TË SËMURË?
A KENI MARRË PJESË
NË PËRCJELLJEN
E NDONJË XHENAZEJE?”*

më të lartësuarat prej të gjitha grave të botës. Gjithashtu sahabet e tij janë të rangjeve më të larta të njerëzimit, menjëherë pas pejgamberëve. Qytetet e tyre, Meka e shenjtë dhe Medina e ndritur, janë qytetet më të shenjta.

- Stërnipërit e çdo personi rrjedhin prej zinxhirit të djemve, kurse Muhammedi (a.s) është trashëguar prej vajzës së tij Fatime. Është farz për çdo kënd ta dojë atë. Ai ka thënë: “Ai që e do Allahun, do të më dojë mua.” Tregus i dashurisë ndaj tij, është të përshtaturit e vetvetes me fenë e tij, rrugën e tij, me sunnetin e tij dhe me bukurinë e tij morale.

- Është vaxhib të duhet Ehli Bejti i tij. Ai thoshte: “Ai që ndien armiqësi ndaj Ehli Bejtit tim, është munafik.”

- Është vaxhib të duash të gjithë shokët e tij (sahabët). Ai thoshte:

“Mos bëni armiqësi kundrejt sahabëve të mi, pas meje. T’i doni ata, do të thotë të më doni mua, armiqësia ndaj tyre do të thotë armiqësi kundër meje. Ai i cili i dëmton ata, do të më ketë dëmtuar mua. Ai, i cili më dëmton mua, do të ketë dëmtuar Allahun e Madhërishëm, dhe Allahu do t’i ndëshkojë ata, të cilët e dëmtojnë Atë.”

- Çdo person, i cili vdes pas moshës së pubertetit, mashkull apo femër goftë, do të pyetet rreth Muhammedit (a.s) në varrin e tij. Pyetja: “Kush është Zoti yt?”, do të pasohet me pyetjen: “Kush është pejgamberi yt?” Është akt adhurimi të lexohen hadithet e Muhammedit (a.s) dhe personi i cili vepron kështu, do t’i jepen sevape. (Këto cilësi dhe shprehje të bukura morale të Muhammedit (a.s) janë përzgjedhur dhe përkthyer nga libri ‘Why Did they Become Muslims?’, Waqf Ikhlâs Publications, nr: 16, Turkey, 1997).

Pejgamberi a.s ka thënë: “Dy gjëra në këtë botë më janë bërë të dashura: gruaja dhe era e mirë, kurse namazi më është bërë drita e syve.”; “Më i miri ndër ju është që më së miri sillet ndaj familjes së vet.”; “O Aishe, asnjëherë mos e kthe nga dera të varfrin. Qoftë edhe me një gjysmë hurme, mbroje veten nga dënimi i xhehennemit.”; “Ata janë vëllezërit tuaj (robërit e luftës). Jepni të hanë atë, që e hani ju dhe të pinë atë që e pini ju.”; “Atë (skllavin), ule pranë vetes. Ha së bashku me të. Nëse nuk e bën këtë atëherë merre një kafshatë, ngjyeje në vaj dhe jepja atij të hajë, gostite atë.”; “A e keni ledhatuar sot ndonjë kokë jetimi? A keni vizituar ndonjë të sëmurë? A keni marrë pjesë në përcjelljen e ndonjë xhenazeje?”

Pejgamberi a.s rrëfen: “Një grua mëkatore sheh një qen në shretëtirë, i cili nga etja e madhe e lëpinte zallin e shkretëtirës. Duke pasur mëshirë ndaj qenit, me këpucën e saj merr ujë dhe i ofron qenit. Në këtë mënyrë kafshës i shuhet etja. Zoti i Madhërishëm ia fali mëkatet asaj gruaje. Ndërkaq, një grua tjetër macen e saj e kishte mbyllur, duk e lënë të uritur.

Së fundi macja ngordhi. Ajo grua, për shkak të mosmëshirës, u bë udhëtare e xhehennemit.”

Pejgamberi (a.s), para vdekjes, dëshi të pastrojë ndërgjegjen, nga çdo njollë e mundshme, prandaj qëndroi në minber dhe iu drejtua masës me këto fjalë: “Muslimanë, nëse e kam qëlluar dikë, ja ku është shpina ime. Nëse dikujt i kam ndonjë borxh, pasuria ime është e tij.” U ngrit një njeri, duke thënë se, Pejgamberi i kishte borxh tre dirhem. Pejgamberi (a.s) i përgjigjet duke thënë: ‘Më mirë, njeriu të ndiejë turp, në këtë botë, se në botën e ardhme’. Dhe menjëherë, ia pagoi borxhin. Dhe vërtet, sikurse i tha Hz. Hadixhja, që në fillim të shpalljes Muhammedit (a.s): “Betohem në Allahun, se Ai kurrë s’ka për të lënë ty të turpëroresh. Sepse ti i mbron të afërmit, ti merr mbi vete barrën e atyre që s’janë të aftë për ta mbajtur, ti i jep të varfrit dhe e ushqen mikun, ti e ndihmon popullin duke gjykuar me drejtësi ndërmjet njerëzve.” Njeri nga dijetarët hebre, Abdullah ibn Selam, porsa e takon Muhammedin (a.s), duke parë dritën në fytyrën e tij, tha: “Ai që ka një fytyrë të tillë, nuk mund të jetë gënjeshtar!” Pas këtyre cilësive të përmendura dhe shumë të papërmendura, çfarë duhet të thonë njerëzit e kohëve të sotme?! Në fund le të përkujtojmë se është e pamundur për njeriun, me mundësitë e tij të kufizuara, ta kuptojë dhe ta përshkruajë madhësinë dhe lartësinë e tij. Poeti arab e shpreh këtë, me këto rreshta: “Muhammedin s’e kam lavdëruar, Me shkrimet që kam hartuar, Por emri i tij më ka vleftësuar, Tregimet që janë rreshtuar.”

Le t’i dërgojmë salavate më të dashurit të Allahut, duke shpresuar ndërmjetësimin e tij në ditën më të frikshme dhe më të vështirë.



JA RESULALL-LLAH, O SIMBOL I PAQES, O MËSHIRË E DHURUAR...

Thonë se qielli pa yje, në netë të errëta idhnake, si dita pa diell, në një mot gjëmimesh, në ditë të hirta, si netë pa yje... U them, bota pa Dritën tënde, si tanësia pa njerinë, ja Resulall-llah...

Sa herë bie nata, pelerinë e hesh-tjes, kur botën në qetësi mbulon, diku larg në horizonte, zëri i trun-gut të hurmës, që për ty digjej në lotët e ndarjes, ende dëgjohet..., në mirazhe malli, drejt Dashnisë Tënde, ja Resulall-llah...

Më thonë t’u flas për Ty, për mallin Tënd... Po a ka ujë Dashnie, që pa-stër nga burimet e qiellit, si rreze Drite zbret, ta lajë zemrën, t’i japë abdest të përzgjedhurish, emrin Tënd ta shqiptojë, veshur me petk malli, ja Resulall-llah..?

Mundohem të hap dyert e historisë, të kapem diku në një cep të pelerinës tënde, të bëhem dëshmitar... Dua të bëhem dëshmitar, bota të dëgjojë! Dua të bëhem dëshmitar, besa të je-tojë, brez pas brezi, si zinxhir Nuri, kapur pas vështrimeve Tuaja plot Butësi Edukatori, ja Resulall-llah..!

Ti, zotëria im, qëndron ulur nën hijen e fladeve, që plagët e lëndua-ra, me bekime mëshironjëse të shë-rojnë... Me duart lart nga qielli, në lutje, ëmbël nxjerr dritë zemre: “O

Zoti im, nëse Ti nuk je i zemëruar me mua, asgjë nuk ka rëndësi..!”

Diku larg, të parët e Taifit dhe pa-suesit e tyre, gëzojnë në hutinë e tyre, të lumtur nga sharja, fyerja e goditja... Ende mbajnë gur në duar, në zenit të paragjykimit... Ata të kanë lënduar, zotëria i humanizmit...

Tashmë, shijojnë lirinë në dhim-bjen tënde, ndërsa Ti lartësohesh në krahët e Pëlqimit hyjnor, që fa-tet e tyre t’i ka lënë në dorë... E Ti, buzëqesh në fytyrën e lajthitjes së tyre dhe vendos, në madhësinë e Mëshirës Tënde, që ata të jetojnë, lirshëm të rrugëtojnë drejt kaderit të tyre, me gurë në duar...

Bijtë e tyre, do ta lartësojnë Zotin Një dhe, me emrin Tënd të bukur, salavate lavdesh, drejt hapësirave të pendimit, gjithnjë do të dërgojnë...

Dhe nga ajo ditë, liria e të hutuarit, vazhdon të përplasit për brigjet e Madhësisë Tënde, duke u thyer në dëshpërim, si dallgë të zemëruara deti në dimërim...

Ja Resulall-llah, o simbol i Paqes, o Mëshirë e dhuruar, që qytetin e gu-rëve sfidove, me lutjen e Mallit Tënd për shekujt plot Teuhid...

Muhamed B. Sytari

Shkodër, 14 janar 2015



Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë Zotit të Vetëm dhe të Pashoq, Krijuesit të gjithësisë, i Cili e krijoi njeriun në formën më të përsosur dhe i dhuroi atij mendjen, më të mrekullueshmen dhunti.

Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë, dhe në çdo ditë, zotërisë tonë, Hz. Muhammedit (a.s), që u dërgua mëshirë dhe butësi për mbarë krijesat: “Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët”.¹

Selamet e dashnisë tonë ia dërgojmë Hz. Muhammedit (a.s), që na paralajmëronte se: “Po afrohet koha që popujt të vërsulen drejt jush nga çdo cep, si egërsirat drejt ushqimit të tyre...”² duke na bërë të kuptojmë se realitetet e sotme, janë thjeshtë reflektime të largimit tonë nga origjina e besimit dhe praktikës së tij.

TË NDERUAR VËLLEZËR DHE MOTRA,

Në realitete të ndryshme, kur njeriu bie në dilemë, nga situata konfuze, që krijohen para syve të tij, ose në raste kur ai përballet me ofendime, sharje, mallkime e lëndime, në hak të fesë së tij dhe familjes së tij të madhe islame në mbarë botën, lypset një tërheqje në paqe drejt zemrës.

Kjo tërheqje, shërben që njeriu të

“NUK KA ZOT TJETËR POS ALL-LLAHUT”!

pyes veten: A jam unë ky që thonë? A është kjo feja ime? A është ky realitet dhe këto ofendime, realisht korrekte në hakun tim si musliman i vetëdijshëm për fenë dhe shpirtin e saj dhe të vetë fesë sime? A jam unë i urdhëruar të vras njerëz që mendojnë ndryshe nga unë, që besojnë ndryshe nga unë, që nga padija mund edhe të tejkalojnë disa kufij të shenjtë për mua, në një shoqëri multikonfesionale dhe multikulturore, që drejtohet nga ligje të caktuara dhe kuvendohet nga një rend konkret? A jam unë dhunues, fytyrë mrrolur, mallkues, ofendues? A kam unë të drejtë të reagoj ndaj padrejtësive në hakun tim dhe asaj që unë besoj dhe si duhet të reagoj?

Në këtë vorbull pyetjesh dhe dilemash (a të ngjashme me to), sidomos në këto ditë, kur mbarë bota dënon me të drejtë aktet terroriste të vrasjeve me gjakftohtësi të një redaksie të tërë gazetarësh (pa marrë parasysh modelin që ata kishin vendosur të ndiqnin në profesionin e tyre dhe përtej bindjes (kjo është një temë debati në vete), fetarizmit a afetarizmit të tyre. Përtej analizave të holla, mendimeve, ideve a komenteve lidhur me ngjarjen, shkaqet, nxitjen a pasojat e saj), muslimani duhet të ndal pak hovin e ditës, të ulet dhe të qetësohet.

Në një reflektim të denjë për personalitetin e tij, të çojë ndër mend transmetimin e sahabiut të nderuar Sheddad ibn Aus (r.a), thotë: Ishim tek i Dërguari i All-llahut (a.s), kur tha: “A ka ndonjë të huaj në mesin tuaj?” Thamë: Jo, o i Dërguar i All-llahut! Atëherë, urdhëroi që të mbyllej dera dhe tha: “Ngrini duart dhe thoni: La ilahe il-lall-llah!” Ne i ngritëm duart për disa momente, pastaj i Dërguari i All-llahut e uli dorën e tij dhe tha: “All-llahumme, Ti më ke dërguar mua me këtë fjalë, më ke urdhëruar ta përhap atë dhe

më ke premtuar për të, xhennetin. Ti nuk e thyen premtimin!” Pastaj tha: “Sihariq për ju, All-llahu ju ka falur!”³

TË NDERUAR VËLLEZËR BESIMTARË,

Në momente të caktuara, njeriu duhet të rikthehet në forcën e fshehur të besimit, atë që qëndron në burim të zemrës dhe shpirtit të tij, që teksa ai përpëlitet në duart e sprovave dhe dilemave të kohës, një zë i fortë dhe i pastër nga brenda i

*“ALL-LLAHUMME,
TI MË KE DËRGUAR MUA
ME KËTË FJALË,
MË KE URDHËRUAR
TA PËRHAP ATË
DHE MË KE PREMTUAR
PËR TË, XHENNETIN.
TI NUK E THYEN
PREMTIMIN!”
PASTAJ THA:
“SIHARIQ PËR JU,
ALL-LLAHU JU KA FALUR!”*

thërret: “Ti je musliman, je krenar para krejt botës me besimin dhe fenë tënde, me kulturën dhe modelin tënd qytetar! Ti je ndjekës i dijes së pastër që buron nga i Gjithëdituri! Ti je falës, në gjurmët e kërkimit të faljes së Falësit! Ti je i urtë, pasi ke pirë nga burimet e urtësisë, që zanafillën e kanë tek sekretet e emrit “El-Hakim”! Ti je i pastër, në zemër, në trup, në mendime, rrugëtues drejt

1. Kur’ani, Teube:128.

2. Transmetuar nga Imam Ahmedi, nga The - bani (r.a).

3. Transmetuar nga Hakimi, Ahmedi, Tabaraniu dhe Ibni Hibbani.



kërkimit të bekimeve hyjnore për të pastrit! Ti je...”

Hadithi i lartpërmendur është një thirrje e singertë, për çdo musliman, që herë pas here, të kthehet në origjinën e besimit të tij dhe të lartësojë me të madhe, nga thirrja e zemrës dhe e shpirtit: “La ilahe il-lall-llah” – “Nuk ka zot tjetër pos All-llahut”!

Sepse kjo është thirrja, që mbledh zemrën e besimtarit dhe e rikthen në origjinën e besimit, teksa realiteteve dhe islamofobisë së pakuptimtë të kësaj kohe, duke i vështruar në sy, i thotë: Unë jam musliman, pasues i Muhammedit (a.s), i cili na ka mësuar se: “Fjala e fundit që kanë zënë njerëzit nga profetësia e parë është: Nëse nuk ke turp, vepra ç'të duash!”.⁴

Ai thoshte se: “Shenjat e hipokritit janë tri: kur flet gënjen, kur premtim nuk e mban premtimin dhe kur zihet në besë, të tradhton”.⁵ Po ashtu, na

4. Ibni Asakir në “Tarikh”, nga Ebu Mes’ud El-Bedri (r.a). (Thotë Imam Mennavi në “Fejdu-Kadir”: “*Ka thënë El-Kadi: Kuptimi i këtij hadithi është, se ajo çfarë ka mbetur nga profetët e mëparshme dhe është ruajtur, është se turpi është frenuesi nga veprimi i veprave të pështira...*”. - Shih: “Fejdu-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 62).

5. Bukhariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Nesaiu, nga Ebu Hurejra (r.a).

ka udhëzuar: “Frikësoju All-llahut kudo që të jesh, pasoje të keqen me një të mirë që ta fshish atë dhe sillu me njerëzit me moral të mirë!”⁶ dhe: “Kijeni frikë All-llahun dhe jini të drejtë me fëmijët tuaj!”.⁷

*“FJALA E FUNDIT
QË KANË ZËNË NJERËZIT
NGA PROFETËSIA
E PARË ËSHTË:
NËSE NUK KE TURP,
VEPRO Ç'TË DUASH!”*

Si mund të jem musliman i denjë për Islamin tim, nëse nuk rrugëtoj drejt mësimave të tij (a.s), teksa thotë: “Ruajuni padrejtësisë, sepse padrejtësia shumëfishohet në ditën e kiametit”⁸ apo: “Ruajuni padrejtësisë, sepse padrejtësia

6. Ahmedi në “El-Musned”, Tirmidhiu, Hakimi në “El-Mustedrek”, Bejhekiu, nga Ebu Dherri (r.a). Etj.

7. Bukhariu dhe Muslimi, nga Numan Ibni Beshir (r.a).

8. Ahmedi në “El-Musned”, Tabaraniu në “El-Kebir”. dhe Bejhekiu në “Shuabul-iman”.

shumëfishohet në ditën e kiametit. Ruajuni koprracisë, sepse koprracia ka shkatërruar ata që ishin para jush, i ka nxitur të derdhin gjakun dhe të legjitimojnë të ndaluarat”.⁹

Jam gjakftoftë përballë provokimeve të ulëta, të cilat, në rastin e duhur i kthej me urtësi dhe argument, sepse përpiqem të zbatoj porosinë e tij (a.s): “Largohu nga nervozizmi!”.¹⁰

“Nëse ke bërë ndonjë të keqe, pasoje me një të mirë”¹¹, thoshte i Dërguari i All-llahut dhe e pasonte me fjalën e tij: “Kur të nervozohet ndonjëri prej jush, nëse është në këmbë, le të ulet, nëse akoma nuk qetësohet, le të shtrihet”¹² për të evituar çdo lloj konflikti drejt të cilit mund të provokohet muslimani në jetë!

Muslimani nuk është arrogant, sepse në mësimet e Profetit (a.s) thuhet: “Më të mirët besimtarë, janë më të sjellshmit e tyre”¹³ si dhe: “Besimtarët me besim më të plotë janë më të sjellshmit dhe më të mirët ndër ju janë më të sjellshmit me gratë e tyre”.¹⁴

All-llahut Mëshirëplotë i lutem të na bëjë prej atyre që thellohen në dije, që udhëzohen në mësimet e të Dashtunit të Zotit, prej atyre që e dëgjojnë fjalën dhe veprojnë më të mirën e saj.

*(Hytbe e mbajtur në xhaminë
e fshatit Domën)*

Shkodër, më 9 janar 2015

9. Ahmedi në “El-Musned” dhe Muslimi, nga Xhabiri (r.a). (Thotë Imam Mennavi në “Fejdu-Kadir”: “*Padrejtësia lind nga errësimi i zemrës, sepse nëse njeriu do të dritësohej me dritën e udhëzimit, do të largohej nga vërshimi drejt padrejtësisë. Në një transmetim nga Ibni Mes’udi (r.a), thuhet: “Zullumqarët do të merren dhe do të vendosen në një tabut (arkivol) prej zjarri, pastaj do të gjuhen në të (pra, në xhehem)”...*”). - Shih: “Fejdu-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 175).

10. Ibni Ebid-Dunja dhe Ibni Asakir, nga një sahabi.

11. Hakimi dhe Bejhekiu në “Shuabul-Iman”, nga Ibni Amri (r.a).

12. Ahmedi në “El-Musned”, Ebu Davudi dhe Ibni Hibbani në “Sahihun” e tij, nga Ebu Dherri (r.a).

13. Ibni Maxheh dhe Hakimi, nga Ibni Omeri (r.a).

14. Tirmidhiu dhe Ibni Hibbani në “Sahihun” e tij, nga Ebu Hurejra (r.a).



Sheikh Vehbi S. Gavoçi

1. SI U ZGJODH?

Sa qe Profeti (a.s) në këtë jetë, nuk caktoi kënd që ta zëvendësojë dhe të trashëgojë udhëheqjen e muslimanëve.

Mirëpo disa shenja u dukën për pëlqimin e Ebu Bekrit si kandidat për këtë detyrë të rëndësishme.

Zonja Aishe (r.a) tregonte: “Sa qe Profeti (a.s) i sëmure herën e fundit, më tha: *“Thirre babën e vëllain tënd, t’ju shkruaj një testament, mbasi po kam frikë se mos ta dëshirojë kush atë gjë, duke thënë se unë jam më i aftë, kurse Zoti (xh.sh) e refuzon atë, si dhe besimtarët refuzojnë këdo jashtë Ebu Bekrit.”* (Fadail Ebu Bekër)

H. Aliu (r.a) thonte: “Profeti (a.s) caktoi Ebu Bekrin si Imam për t’u prirë njerëzve në të falur, megjithëse më ka parë e nuk kam qenë jashtë Medines, as kam qenë i sëmure dhe sikur të donte ai të më caktonte, do të më kishte caktuar. Na pëlqejmë për jetën tonë çka ka pëlqyer Profeti (a.s) për fenë tonë. (M. Rijad)

Zonja Aishe tregonte gjithashtu se, sa qe Profeti (a.s) në sëmurdje të rëndë e u lodh, tha: *“Urdhëroni Ebu Bekrin të prijë në të falurit.”* E shoqja i tha: Hej i dërguari i Zotit (xh.sh), Ebu Bekri, nëse qëndron në vend tënd në të falurit, nuk ia dëgjojnë njerëzit leximin e Kur’anit nga të qarit, sepse ai qan kur lexon Kur’anin, urdhëro Ymerin t’u prijë njerëzve, mbasi ai ka zë të fortë (të lartë). Edhe Hafsa, vajza e Ymerit, i tha të jatit të përgatitet për të drejtuar të falurit.

Në këtë rast Profeti (a.s) u tha atyre shoqërisht: *“Ju jeni si ato gratë që dëshën të rrëshqisnin Hz. Jusufin (a.s), urdhëroni Ebu Bekrin të drejtojë si imam.”* (M. Rijad)

Tregojnë edhe një ngjarje tjetër. Er-

EBU BEKRI (R.A) KALIF

dhi një grua te Profeti (a.s) në Mekë në ato ditë që u çlirua ky qytet. Foli me atë Zotëri disa fjalë e i bëri disa pyetje. Ndër të tjera ajo pyeti: Si thon-te i dërguari i Zotit (xh.sh), po të vinte njëherë e mos ta gjente, (d.m.th. po të vdiste Profeti (a.s)?)

Profeti (a.s) iu përgjigj: *“Nëse nuk më gjen mua, shko te Ebu Bekri.”* (Bukhari)

Nga vdekja e Profetit (a.s), sahabet u shkrehën në vaj, me lot e me dihatje, iu zu të parit e syve, iu ngushtua vendi i të ndënjes, iu duk se Medineja u bë e gjitha terrinë, mbasi shkoi drita e zemrave të tyre.

Qanë, dihatën, derisa u lodhën, mandej iu mbështetën Zotit (xh.sh) për t’iu dhënë durim për ngjarjen më të rëndë e më dëshpëruese në jetën e tyre.

Shpresa se shpejt do të bashkohen me Të në jetën e pafund, në pëlqimin e Zotit (xh.sh), në xhenet, ua lehtësoi atë ngjarje, ua pakësoi atë dëshpërim.

Në atë kohë sahabet nga Medineja u bashkuan në kullën e Beni Saides për të zgjedhur zëvendësin mbas Profetit (a.s), që të sundojë popullin, të mbrojë të drejtat, të sigurojë paqën e qetësinë në vend e të mbrojë shtetin nga lakmuesit e huaj. Disa sahabe prej Medines propozuan që kalifi të jetë nga Medineja, mbasi ata kanë pranuar edhe muslimanët në vendin e tyre, kanë luftuar për të mëkëmbur qeverinë e për ta forcuar atë. Disa të tjerë propozuan të jenë dy kalifë, njëri prej Medines e tjetri prej Mekës.

Ebu Bekri me Ymerin e disa shokë mësuan për atë mbledhje. Mbas pak fjalësh të buta e të egra, të gjithë pranuan që Ebu Bekri të ishte kalif, pse ishte prej fisit Kurejshi, mbasi Profeti (a.s) e la si zëvendës për të prirë si imam para sahabeve.

H. Ymeri në atë mbledhje u shpreh: *“A nuk dini se Profeti (a.s), ka urdhëruar që Ebu Bekri t’u prijë njerëzve në të falurit? E cilit ia thotë zemra të dalë para Ebu Bekrit?”*

Njerëzit e pranishëm u përgjigjën: *“Zoti na ruajt, ne nuk dalim para Ebu Bekrit.”* (Nesai)

U mbledhën atë ditë në xhaminë e

Profetit (a.s) e i dhanë besën Hz. Ebu Bekrit si kalif, e pranuan atë, prem-tuan se janë gati të zbatojnë urdhrat e tij simbas mësimëve të fesë Islame.

Natën e të martës u varros Profeti (a.s), u largua nga sytë e njerëzve, por jo nga zemrat, u largua trupi i tij, kurse gjurmët e tij, këshillat e tija ishin përherë në veshët, në zemrën e në shpirtin e tyre.

Të mërkurën, me 14 rebiul ev-vel njerëzit u gjetën me kalif Ebu Bekrin. Ai foli para njerëzve, parashtroi programin e tij dhe sahabet pranuan çka paraqiti e propozoi.

2. EBU BEKRI BËRI PUNË TË MËDHA

Ebu Bekri filloi të zbatojë detyrën e tij si zëvendës i Profetit (a.s). Në detyrën e tij si kalif Ebu Bekri bëri punë të mëdha.

Puna e parë qe dërgimi i Usamës në Mu’të për të luftuar me romakët që e kërcënonin qeverinë Islame.

Disa sahabe kundërshtuan vendimin e emërimit të Usamës. Dikush tha: Usama është djalë i ri 18-vjeçar, si mund të jetë ai komandant ushtrie, kur ka sahabe të mëdhenj që mund të jenë drejtues ushtarakë si Ymeri me Alinë? Ndonjë tjetër tha: Sa arabë i sollën shpinën fesë Islame, po presin rastin për të sulmuar Medinen, ashtu dhe romakët do të shtyjnë arabët që janë aleatë me ta.

Ebu Bekri qëndroi si mali, tha se do të plotësojë porosinë e Profetit (a.s). Nga ai qëndrim i fortë dhe i vendosur u zbutën kundërshtarët. Ebu Bekri urdhëroi ushtrinë të marshojë, doli ta përcjellë atë me sahabet dhe kërkoi prej Usamës të lërë Hz. Ymerin në Medine, mbasi kishte nevojë për të. Usamja pranoi dhe zbatoi detyrën e ngarkuar.

Ushtria shkoi për në Mu’të. Romakët dhe arabët që ishin me ta, u frikësuan dhe thanë: Kur këta kanë mundësi për të dërguar këtë ushtri kundër nesh, atëherë sa e madhe është ushtria e tyre? U larguan nga vendi i luftës. Usamja ndëshkoi disa fise arabe afër Mu’tes, të cilët i sollën shpinën fesë. Mbas

40 ditësh ushtria u kthye fitimtare.

Askush nuk sulmoi Medinën, sepse edhe disa fise arabe që menduan të luftojnë, u frikësuan, kur panë që ushtria islame bëri një rrugë gati 900 km, pra fuqia në Medine do të ishte shumë e madhe.

Kështu ushtria u nis e u kthye me fitore të madhe materiale e morale, pa humbur asnjë ushtar. Kjo gjë e forcoi dashurinë e sahabeve për Hz.Ebu Bekrin (r.a) e besimin në vendimet e tij.

Më pas ndodhi një ngatërresë e vogël e cila u kapërcye. Aishja (r.a) ka treguar: “Më dërgoi Hz. Fatimeja te babai im për të kërkuar trashëgiminë, gjërat që i ka lënë trashëgim Profeti (a.s)”. Ebu Bekri iu përgjigj vajzës së vet: Thuaji zonjës Fatime se Profeti (a.s) ka sqaruar se: “*Ne Profetët nuk trashëgohejmë, për atë që lëmë mbas nesh, ajo është lëmoshë.*” (Bukhari)

Këtë hadith e miratoi Hz.Ymeri, Hz.Osmani, Hz.Aliu, Hz.Ab-basi (xhaxhai i Profetit (a.s) Tal-ha, Ebu Hurejre etj.

Po të ishte që profetët të lënë trashëgimi, ndokush mund të mendonte se puna që ka bërë Profeti për të përhapur fenë synonte për të bërë edhe pasuri për vete ose familjen e vet.

Në këtë mënyrë i këputej rruga çdo akuze të padrejtë. Dihet se Profetët kanë punuar për hir të Zotit e jo për këtë jetë, as për vete, as për familjet e tyre.

Sahabet e pranuan këtë zgjidhje që dha Ebu Bekri me shokë, se sikur të kishte familja e atij Zotëri të drejtën e trashëgimisë, ajo do t'i jepej Hz. Aishes, vajzës së tij, gruas së Profetit (a.s).

Bile Hz.Aliu (r.a) më vonë, kur u emërua kalif, nuk ndryshoi gjë, nuk u dha gjë nipërve të Profetit, mbasi nuk meritonin.

Ajo ngatërresë u zgjidh, posa u shfaq, por disa të huaj ende bëjnë tregti me këtë çështje, kur flasin për sahabet e mëdhenj, bile me më të madhin, që është, pa fjalë, Hz.Ebu Bekri (r.a).

3. LUFTA KUNDËR MURTEDAVE

Qysh në kohë të Profetit (a.s) u pat paraqitur një që u quajt Mesejleme, gjoja si Profet. Profeti (a.s) e përgënjeshtrroi atë e këdo që shitet mbas tij si Profet (si p.sh. Kadjaniu i Lahorit, sot pasuesit e tij quhen Ahmedit), duke thënë: La nebi-je baedi që d.m.th. “*Nuk ka profet mbas meje.*”

Kur ndërroi jetë Profeti (a.s), ai, Me-

sejleme, ngriti kokën dhe mbledhi fiset afër tij në Nexhd e vende të tjera kundër qeverisë në Medine, mbasi ai po qenka profet e trashëgon Muhammedin (a.s).

Disa shkuan mbas gënjeshtres së tij për interesa e shkaqe të ndryshme dhe u përpoqën të formojnë edhe ushtri.

Po kështu vepruan jo drejt edhe disa arabë të tjerë, që qëndruan në besim, por e panë të rëndë të japin zeqatin, duke thënë: Zoti (xh.sh) ka urdhëruar Profetin për të marrë zeqatin, silleni atë, ne ia japim atij zeqatin.

Lajmi i keq mbërrini në Medinën e shkëlqyeshme. Ebu Bekri pa vonesë mbledhi këshillin për ta studiuar këtë gjest të parregullt që ndodhi për të parën herë në jetën Islame.

Në mbledhje të këshillit u bënë diskutime. Njëri nga pjesëmarrësit tha: Unë mendoj të durojmë pak, deri sa të forcohem, mbasi armiku ka mbledhur ushtri të madhe e është larg nesh 100 km.

Kur i erdhi radha Ebu Bekrit tha: “Jo, nuk duhet të vonohemi e të presim derisa armiku të forcohet më tepër, nuk duhet të pranojmë që të vonohet dhënia e zeqatit, që është e drejta e të vobektit në pasurinë e pasanikut. Beto hem se do të luftoj këdo që dallon zeqatin nga të falurit, mbasi zeqati është e drejta në pasuri.”

Këshilltarët, posa panë entuziazmin e Ebu Bekrit e dëgjuan fjalën e tij, lanë propozimet e frikën e tyre, pëlqyen këshillën e kalifit Ebu Bekër.

Kështu pra, u interesua Ebu Bekri me shokë për të formuar ushtrinë që do të luftonte larg, formoi 11 formacione me 11 komanda dhe i urdhëroi t'i sulmojnë shpejt armiqtë, para se të organizohet e të bashkohet në një vend.

Ashtu u bë, mbas disa luftërave të rrepta në disa vende, veçanërisht kundër Mesejleses që kishte mbledhur një fuqi të madhe nga fisi i tij e fise të afërta dhe ishte tubuar në një tokë të madhe të rrethuar me mure.

Sahabet qëndruan disa ditë afër asaj toke dhe mendonin si të hynin e si ta zhvillonin luftën me ata armiq të fesë.

Një sahabë u tha shokëve të vet: Kur të vijë nata, më vini në një shportë të madhe, më hidhni me fuqi lart afër murit të asaj toke, që të bie brenda e, nëse unë mundem, do t'u hap derën, hyni ju në atë tokë dhe sulmoni armikun.

Erdhi nata, ushtarët e Mesejleses

HZ. ALIU (R.A) THONTE:

“PROFETI (A.S) CAKTOI

EBU BEKRIN SI IMAM

PËR T’U PRIRË NJERËZVE

NË TË FALUR,

MEGJITHËSE MË KA PARË

E NUK KAM QENË

JASHTË MEDINES,

AS KAM QENË I SËMURË

DHE SIKUR TË DONTË AI

TË MË CAKTONTË,

DO TË MË KISHTE CAKTUAR.

NA PËLQEJMË

PËR JETËN TONË

ÇKA KA PËLQYER

PROFETI (A.S)

PËR FENË TONË.

ishin të dehur nga pija. Ushtarët islamë e hodhën sokun e tyre. Kur ra në atë tokë, rojtarët të habitur u larguan. Ai me të shpejtë vrapoi te dera, e hapi atë. Sahabet sulmuan dhe fituan be tejën e egër.

Ai që pat mbytur Hz.Hamzën, xhaxhain e Profetit (a.s), quhej Vahshi, e gjuajti me shigjetë Mesejlemen prej së largu, i cili ra për tokë i vdekur.

Me zhdukjen e atij zjarri të dëmshëm, me vrasjen e gënjeshtarit Mesejleme, pasuesit e tij i hapën sytë. Edhe ata që nuk deshën të japin zeqat, u kthyen në të mirën e Zotit (xh.sh), në fe dhe u rregulluan me kërkesat e fesë Islame.

Disa dijetarë kanë thënë: Sikur të mos luftonte Ebu Bekri me sahabë Mesejlemen ashtu shpejt, do të ishte dobësuar feja Islame, do të kishte pësuar grindje e përçarje, siç ka ndodhur në disa fe e ide njerëzore.



Salim Esh-Shejki*

Prej gabimeve shkencore të mbuluara me rroba të akides së saktë e të shëndoshë, të disa dijetarëve bashkëkohorë seleftit, është zhveshja e dashurisë së Pejgamberit (a.s) prej dimensioneve emocionale njerëzore, të lidhura me ndjenjat e buta dhe fisnike të zemrës, të cilat ndodhin mes të dashurit dhe të dashuruarit. Duke e bërë atë dashuri thjesht sipërfaqësore, që nuk ka, veçse një kuptim të vetëm, nënshtrim sipërfaqësor të thatë prej çdo ndjenje të zemrës të kërkuar nga çdo dashuri njerëzore. Dashuria e Pejgamberit (a.s), tek ata, është bindja ndaj tij dhe asgjë tjetër. Ata i kanë bërë gjurmët e dashurisë dhe kërkesat e saj, dhe mbi të gjitha bindjen, sikur ajo është vetë dashuria duke e zhveshur, me këtë kuptim, prej origjinës së saj, e cila do të thotë mall, përvëlím i zemrës dhe lidhje ndjenjash, me gjithë domethënien që mbart fjala mes të dashurit dhe të dashuruarit.

Kam dëgjuar njërin prej tyre, që 25 vjet më parë, duke thënë dhe ai jetonte në Medine Munevere: Unë, me mirësinë e Allahut, kam tre vjet në Medine dhe akoma nuk e kam vizituar varrin e Pejgamberit (a.s)! E thoshte këtë, për të treguar saktësinë e akides së tij dhe dashurinë për Pejgamberin (a.s)!

Një tjetër, po komentonte ngjarjen e marrëveshjes së Hudejbijes dhe mënyrën se si sahabet rendnin me njëritjetrin pas ujit të abdesit të Pejgamberit (a.s) për ta spërkatur fytyrën dhe trupin e tyre me atë ujë; nëse unë do të kisha qenë në vendin e tyre, nuk do ta bëja atë veprim! Sikur ai, habitej me heshtjen e Pejgamberit (a.s) ndaj asaj, që ai e shikonte tejkalim të sahabeve në shfaqjen e dashurisë së tyre

NË PREHRIN E DASHURISË SË PEJGAMBERIT (A.S)

për të Dërguarin e Allahut (a.s).

Kur flas për kuptimin e ndjenjave njerëzore të lidhura me dashurinë pejgamberike fisnike, unë kam për qëllim përshkrimin e Aliut (r.a) kur u pyet se, si ka qenë dashuria juaj për të Dërguarin (a.s), ai tha: “Ka qenë për ne, pasha Allahun, më i dashur se sa pasuria, fëmijët, baballarët, nënat dhe se sa uji i ftohtë për etjen!

Medito rreth këtij përshkrimi të hollësishëm “se sa uji i ftohtë për etjen”!

E tillë ka ardhur edhe në historinë e vrasjes së Zejd ibn Dethenne. Ibn Is’haku ka thënë: Një pari kurejshësh u mblodhën, në mes tyre edhe Ebu Sufjan ibn Harb, i cili në momentin e ekzekutimit të sahbiut i tha: Po të betohem, o Zejd, e do të kishe dashur që Muhammedi të jetë këtu, në vend tënd e t’ia këpusim kokën dhe ti të jesh pranë familjes tënde? Zejdi i tha: Pasha Allahun, nuk dua që Muhammedi në atë vend atje ku është, ta shpojë një ferrë që t’i sjellë dhimbje, ndërkohë unë të jem duke ndenjur me familjen time! Ebu Sufjani tha: Nuk kam parë kurrë njerëz të dua dikën, siç e duan shokët e Muhammedit, Muhammedin!

Tregon Aisheja (r.a): “Një njeri erdhi tek i Dërguari i Allahut (a.s) dhe i tha: O i Dërguar i Allahut, ti je për mua më i dashur se sa vetja ime; ti je për mua më i dashur se sa fëmija im, ndërkohë që jam në shtëpi të kujtoj ty e nuk mund të duroj, derisa të vij e të të shikoj. Kur kujtoj vdekjen time e vdekjen tënde, dhe di se kur të hysh në xhenet do të lartësohesh së bashku me Pejgamberët e tjerë, e unë të hyjë në xhenet, kam frikë se nuk do të të shikoj!” Pejgamberi (a.s) nuk i ktheu përgjigje, derisa zbriti Xhibrili me këtë ajet: “Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata, të cilët i ka bekuar Allahu...”.

Gjithashtu transmetohet nga Sead ibn Vekkas se ai ka thënë: Në luftën e Uhudit, një gruas iu vra burri, vëllai

dhe babai i saj, kur e ngushëlluan, ajo tha: Si është i Dërguari i Allahut (a.s)?

- Është mirë, o nëna e filanit. Ai, el-hamdulillah, është ashtu siç ke dëshirë ta shohësh.

- Më tregoni ku është, ta shoh me sytë e mi.

I bënë me shenj se ku ndodhet dhe kur e pa tha: Çdo fatkeqësi, pasi të pash ty, nuk është më e tillë!

Dhe shumë tekste të tjera, të cilat nuk mund të numërohen, tregojnë lidhjen më të lart emocionale njerëzore, mes sahabeve dhe Pejgamberit (a.s).

Së fundmi them: Zhveshja e dashurisë prej ndjenjave të saj njerëzore dhe shndërrimi i saj në akt sipërfaqësor, i thatë, i ngrirë, i vyshkur dhe i zhveshur prej shtysave dhe nxitësve të thellë njerëzor, ka bërë shumë prej atyre që besojnë në këtë zhveshje, të bien në një mënyrë sipërfaqësore, që nuk ke ka njohë historia më parë, në kuptimin e zbatimit të sunetit dhe rrugës sipërfaqësore të Pejgamberit (a.s).

Për këtë, një pjesë e tyre, më shumë kujdesen për rrugën sipërfaqësore të Pejgamberit (a.s) dhe në të njëjtën kohë, janë prej njerëzve më të largët në përmbajtjen që lidhet me gjendjen dhe sjelljet e brendshme fisnike të Pejgamberit (a.s). Shqetësimi dhe interesimi për ta është i fokusuar në atë çfarë duket në sunetin e Pejgamberit (a.s), duke neglizhuar qartë në pasimin e rrugës së tij të brendshme, që lidhet me butësinë, mëshirën, dhembshurinë, kujdesin për shpëtimin e të tjerëve, por me butësi dhe dhembshuri zemre, fqinjësi të mirë dhe të tjera si këto cilësi pejgamberike e sjellje të tij fisnike, sal’la Llahu alejhi ve sel’lem.

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja

*Anëtar i Këshillit të Unionit Botëror të Dijetarëve Myslimanë



Naim Drijaj, imam, xhamia "Parrucë"

Allahu xh.sh. në Kuranin famë-lartë thotë: "Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me "selam"! (Ahzab,56)

Buhariu raporton se Ebu El Alijeh ka thënë se salavati i Allahut për të Dërguarit e Tij do të thotë se Allahu e lavdëron atë para melekëve, ndër-sa salavati i melekëve është lutje (dua) që i drejtojnë ata Allahut për profetin. (Hadislerle Kur'ani kerim Tefsiri Ibn Kesir, cilt 12.s.6578. Çagri yayinlari)

Fjala salavat është shumësi i fjalës salat (lutje), që në përdorimin tonë gjuhësor ka marrë trajtën e njëjësit, prandaj themi salavat.

DISA NGA DOBITË E DËRGIMIT TË SALAVATEVE:

1. Përfitimi i dhjetë salavateve nga Allahu xh.sh. - thotë Pejgamberi (a.s.): "Kush më dërgon një salavat, Allahu atij i dërgon dhjetë salavate" (Buhariu)

2. Kthimi i salavatit prej Pejgamberit a.s. "Nuk ka asnjë musliman që më përshëndetë me selam e që Allahu të ma kthen shpirtin për t'ia kthyer selamin". (Imam Ahmed, Ebu Davud).

3. Afërsia me Pejgamberin a.s. "Vërtetë njeriu më i afërt me mua në Ditën e gjykimit është personi që më së shumti më ka dërguar salavat".

4. Kushtëzohet pranimi i lutjes pas salavatit - Transmeton Aliu r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Nuk ka asnjë lutje që në mes saj e Qiellit nuk ka hixhab (pengesë) përderisa nuk

VLERA DHE RËNDËSIA E SALAVATIT

dërgohet salavat mbi mua dhe vetëm pasi të dërgohet salavati ngrihet ajo pengesë". (Tirmidhiu).

5. Melekt luten për ata që dërgojnë salavat - Muhamedi a.s. ka thënë: "Allahu ka krijuar një grup melekesh të cilët i urdhëron të kërkojnë vendtubime aty ku përmendet Allahu. Nëse gjejnë vende të tilla, ndalen pranë tyre, ku bëjnë amin në lutjet e besimtarëve të pranishëm, nëse ata dërgojnë salavat, melekt së bashku me ta dërgojnë salavat, derisa besimtarët të shpërndahen, pastaj melaiket i thonë njëri tjetrit, lum për këta që po kthehen të falur prej Allahut".

6. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Dita më e zgjedhur e javës është dita e xhuma. Përpikuni që gjatë kësaj dite të më dërgoni sa më shumë salavate, sepse unë do të njoftohem për salavatet tuaja." (Ebu Davud)

7. Salavati shkak i shpëtimit nga vështirësitë. Nga Sehl ibn Sad transmetohet të ketë thënë: "Erdhi një njeri tek Pejgamberi a.s. duke iu ankuar për problemet e shumta jetësore, varfërinë e madhe dhe vështirësitë e ndryshme, atëherë Muhammedi a.s. i tha: "Kur të hysh në shtëpinë tënde jep selam është dikush aty apo jo, pastaj më dërgo salavat mua dhe lexo Kul Huvallahu Ehad". Ky njeri filloi të vepronte në këtë mënyrë derisa gradualisht filloi t'i përmirësohet gjendja. Zoti ia shtoi pasurinë aq shumë sa që ai u shpërndante të afërmëve dhe fqinjëve të tij. (Ibn Kajjim, Xhelaul Efham fi fadli essalat ala hajril-enam)

8. Përfitimi i mëshirës Hyjnore. Nga Umer ibni Hattabi transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: "Kushdo që ka marrë abdes le të thotë më pas: "Eshhedu en la ilahe il-lall-llah ve enne Muhameden abduhu ve Resulu-hu", pastaj le të më dërgon salavat, sepse këtij besimtari do t'i hapen dyert e mëshirës së Zotit. (Ibn Kaj-

jim, Xhelaul Efham fi fadli essalat ala hajril-enam)

Salavatet ndikojnë që në zemër të besimtarit të shtohet dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut. Njeriu e përmend shpesh atë që do dhe në çdo rast përpiket të flasë me dashuri për të duke treguar për virtytet e tij.

Ibnul Kajjimi ka thënë: "Sa herë që përmend Atë që don duke vënë në dukje cilësitë e tij të mira, të shtohet edhe më shumë dashuria për të".

PEJGAMBERI A.S.

KA THËNË:

"VËRTETË NJERIU

MË I AFËRT ME MUA

NË DITËN E GJYKIMIT

ËSHTË PERSONI

QË MË SË SHUMTI

MË KA DËRGUAR

SALAVAT".

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: "Koprrac është ai person i cili nuk dërgon salavat mbi mua kur dëgjon emrin tim të përmendet." (Ahmedi, Tirmidhiu).

Transmetohet nga Abdurrahman Bin Avfi se ka thënë: "Shkova njëherë tek Pejgamberi, a.s. dhe e gjeta në sexhde. Prita sa të përfundonte atë sexhde që vazhdoi shumë gjatë. Pastaj më tha: "Më erdhi Xhibrili a.s. dhe më tha: Kush përcjellë salavate mbi ty, unë do t'i përcjelli salavate atij. Kush përcjellë selame mbi ty, unë do t'i përcjellë selame atij. Për këtë arsye qëndrova gjatë në sexhde për ta falënderuar Allahun. (Transmeton Hakimi dhe Ahmedi).

MYFTIU TAKON IMAMËT E QYTETIT NË PRAG TË KONFERENCËS SË IV-T

Në prag të Konferencës së IV-t të imamëve dhe këshillave të xhamive të Shkodrës, Myftiu, Imam Muhamed Sytari, ka mbledhur ditën e mërkurë, më 7 janar 2015, imamët e xhamive të qytetit, për të diskutuar bashkërisht rreth disa prej tematikave të rëndësishme, që lidhen me aktualitetin.

Fillimisht, Myftiu ka falënderuar angazhimin që imamët mundohen të kenë, në shërbim të vlerave islame dhe përhapjes së dritës së Thirrjes Islame në Shkodër dhe përtej saj.

Gjatë takimit të tij me imamët e nderuar, Myftiu ka theksuar se ky vit ka një vlerë të madhe për punën dhe shërbimet e secilit, në drejtim të rritjes së cilësisë dhe sasisë së aktiviteteve dhe takimeve, brenda xhamisë dhe jashtë saj. Në këtë kontekst, Myftiu ka lajmëruar imamët e pranishëm për një sërë aktiviteteve dhe projekteve të dobishme në këtë drejtim.



Në këtë takim është vënë theksi edhe tek nxitja e xhemateve për të respektuar maksimalisht gjurmët e identitetit islam, duke mos toleruar shkeljen tinzare të tyre, sikurse ka për tendencë të ndodhë, sidomos gjatë dy dekadave të fundit.

Në këtë takim, që ka zgjatur mbi

një orë, është folur edhe për tema aktuale, që lidhen me Islamin në Shkodër, disa nga sfidat e tij të reja dhe angazhimin e Myftinisë Shkodër me krejt stafin e saj të gjerë dhe besimtarët, për të mos lejuar tjetërsimin e frymës së harmonisë qytetare nga askush, sidomos nga të veshur me petkun e cilësdo fé.

BASHKËBISEDIM ME TEMË: “PËRSE KJO FRIKË NGA ISLAMI?”

Paraditën e së shtunës, më 10 janar 2015, në një ambient të ngrohtë intelektual, në mesin e teologëve, imamëve, intelektualëve dhe aktivistëve të Myftinisë Shkodër, është organizuar promovimi i dy botimeve të reja me titull: “Përse kjo frikë nga Islami?”, nga Dr. Muhammed Said Ramadan El-Buti dhe Xheudet Said, si dhe: “Reformatori i madh Umer ibn Abdulazizi”, nga Dr. Jusuf El-Karadavi.

Në fjalën e tij hapëse, teologu Arben Halluni, ka theksuar se në atmosferën e ngrohtë të Muajit të Begatë, në të cilin përkujtohet Lindja e Hz. Muhammedit (a.s) dhe vitit jubilar të





Mr. Muhidin Ahmeti*

Para disa kohësh po lexoja që në Indonezi 120.000 njerëz kanë dhënë provimin e hifzit (hafizllëkut) njëkohësisht. Më ra në mend një ide, për ne do të ishte mirë edhe me 110.000 hafizë dhe 10.000 fizikanë bërthamorë por ja kështu është... Askush nuk na vret në koncept. Ne e vrasim vetveten në koncept.

25 vjetorit të lirisë së besimit, vjen dhe ky aktivitet, që përkon edhe me daljen në qarkullim të dy botimeve të reja të Myftinisë Shkodër.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, në fjalën e tij, ka thënë se realitetet me të cilat po përballet njerëzimi, në çdo cep të botës, dëshmon për dhunë, terror, vrasje të njerëzve të pafajshëm, varfëri e skamje, uri e islamofobi, për të cilën ne nuk jemi të kënaqur dhe lutemi për qartësimin dhe shërimin e saj.

Njëkohësisht, Myftiu i është referuar edhe ndodhive të ditëve të fundit në Francë, ku ka përmendur se qëndrimi i institucionit të muslimanëve shqiptar (KMSH) ka qenë shumë korrekt dhe i menjëhershëm, duke dënuar çdo lloj shfaqje të terrorit, pavarësisht situatave dhe shkaqeve, që mbeten objekt debati e komentesh, jashtë këtij takimi.

Në këtë situatë, - ka vazhduar Myftiu, ku një valë islamofobe, duket se ka nisur të përfshijë Evropën e cepa të ndryshëm të botës, përfshi edhe vendin tonë, ku jemi befasuar edhe me shkrime dhe deklarata, që do t'i kishte zili edhe Marks, detyra e jonë është që të dëshmojmë besimin dhe

NE MUSLIMANËT KEMI DIJETARË PËR TË EKSPORTUAR..?!

Ne mendojmë se All-llahu prej nesh kërkon vetëm mësimin e fesë, por nuk është ashtu - Ai kërkon studimin e të gjitha shkencave dhe muslimanët e mëhershëm këtë më mirë e kanë kuptuar se ne.

Sot kushdo mund të diskutojë për dhe mbi fenë dhe si duket kjo gati gjithkujt i është bërë hobi, por kur dikush e hap temën mbi fizikën nukleare matematikën, arkitekturën, ose ndonjë shkencë tjetër, atëherë fillon heshtja.

Por çfarë është edhe më keq, ka shumë prej atyre që e studiojnë fenë vetëm që të mund t'u imponohen të

tjerëve si autoritet, ose të kundërshtojnë mendimin e tjetrit, ose për të fituar famë. Nuk ke nevojë ti të jesh fekih apo hafiz për të kuptuar mirë fenë dhe mjedisin (Tekstin dhe kontekstin). Zjarri pikërisht do të kallet me një hafiz që e ka mësuar Kur'anin vetëm që ta lavdërojë të tjerët. Kjo është arsye pse mua nuk më ka interesuar shumë leximi i fikhut, më shumë më ka interesuar, filozofia, tesavufi, edukimi i shpirtit dhe zbutja e nefsit.

** Imam, xhamia "Mesxhid El-Resul",
Wels - Austri*

kulturën tonë islame, në jetën e përditshme, si përçues të denjë të mësimëve të Kur'anit dhe traditave të Hz. Muhammedit (a.s.). Këto mësimë nuk janë ato, për të cilat flitet dhe dëgjohet sot, edhe nga qarqe intelektuale, që u mungon njohuria e duhur dhe thellimi në këto çështje.

Myftiu ka folur edhe për shqetësimin e tij, të cilin ia ka ngritur edhe Kryetarit të Bashkisë Shkodër, për mos respektimin e ekuilibrave fetarë në Shkodër, ku sërish ka përmendur edhe provokimin fetar të ndodhur me 26 dhjetor 2014 në xhaminë e Sulltan Mehmet Fatihut, në kalanë e Shkodrës.

Ndërkohë në fjalën e tij, thirrësi islam Lavdrim Hamja, pasi ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre, ka hedhur dritë mbi dy botimet e tij të fundit dhe është ndalur te shpjegimi i konceptit të kalifit në Islam.

Ai është ndalur më konkretisht te modeli i reformatorit dhe prijësit të madh islam, Umer ibn Abdulaziz, që konsiderohet si një udhëheqës i drejtë, i ndershëm, largpamës dhe asket, në ditët e të cilit, kalifati islam arriti mirëqenie të madhe dhe

drejtësi të pashembullt, sidomos me jomuslimanët, të drejtat e të cilëve ishin të garantuara dhe të mbrojtura me ligje konkrete.

Aktiviteti ka vijuar edhe me biseda të shumta dhe ndërhyrje, që kanë nxjerrë në pah rëndësinë e këtyre botimeve dhe nevojën e angazhimit për të punuar sa më shumë në rrugën e përhapjes së mësimëve të Kur'anit dhe traditave profetike në realitetet shqiptare.



Ditën e shtunë, më 12 rebiul-evel 1436, që korrespondon me datën 3 janar 2015, në ditën e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hazreti Muhammedit (a.s), Myftinia Shkodër ka nisur serinë e aktiviteteve, në përkujtim të mesazhit dhe personalitetit të Vulës së dërguarve të All-lahut, Hz. Muhammedit (a.s).

Pas namazit të mesditës, në xhaminë e re të “Dy Vajzave”, është organizuar një tribunë fetare për motrat muslimane, me temë: “Shembulli dhe Mëshira e Hz. Muhammedit (a.s)”.

Aktiviteti ka nisur me një historik të shkurtër të xhamisë së re dhe shkakut të emërimit të saj, si “Xhamia e Dy Vajzave”, në kujtim të dy studenteve kuvajtiane, që humbën jetën në një aksident automobilistik.

Më pas, teologia Ferzet Ndoja, ka folur mbi shembullin e mëshirës së Hz. Muhammedit (a.s), në raport me njerëzit dhe mbarë krijesat e Zotit. Në fjalën e saj, vajza e nderuar ka hedhur dritë mbi disa aspekte të kësaj mëshire, duke vënë theksin te nevoja që ka sot shoqëria shqiptare për të reflektuar modelin e humanizmit dhe mëshirës së të dërguarit të All-lahut, në jetë.

TRIBUNA FETARE: “SHEMBULLI DHE MËSHIRA E HZ. MUHAMMEDIT (A.S)”



Në ligjëratën e dytë, teologia Zamira Bushati, ka folur mbi nevojën që ka studimi i jetës së Profetit Muhammed (a.s), si një ftesë hyjnore, që nxit besimtarët për të pasur shembullin më të mirë në jetë, atë të Hz. Muhammedit (a.s). Në ligjëratën e saj, ka hedhur dritë edhe mbi vlerën që ka shtimi i salavatit në jetë, si një garanci suksesi dhe mirësie për praktikuesit e tij.

Aktiviteti ka vijuar me recitime dhe lutje, të zhvilluara me xhemat, që kanë krijuar emocione të bukura dhe kënaqësi shpirtërore, të dëshmuar në mesin e besimtareve të pranishme në xhami.

Në fund të aktivitetit, për të pranishmet është shpërndarë broshura e re e botuar nga Myftinia Shkodër, me rastin e Mevludit të sivjetshëm.

“MEXHLISI I HADITHIT”, NË PËRKUJTIM TË MISIONIT TË HZ. MUHAMMEDIT (A.S)



Pasditën e së shtunës, më 3 janar 2015, në ditën e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hazreti Muhammedit (a.s), Myftinia Shkodër ka organizuar një aktivitet fetar, me temë: “Mexhlisi i Hadithit”.

Pas faljes së namazit të iqindisë, imamët e nderuar dhe xhemati pje-

sëmarrës, janë rreshtuar, në një tubim diturie, ku janë lexuar rreth pesëdhjetë hadithe të Profetit Muhammed (a.s), me komente dhe shpjegime të goditura, në funksion të kuptimit dhe mësimi të tyre nga të pranishmit.

Gjatë këtij aktiviteti, imamët e nderuar: Durim Kasemi, Naim Drijaj, Hy-

sen Muça, Ademir Xama, Ervil Kuçi, Lavdrim Hamja, Fejzi Zaganjori, Mithat Myftija, Arben Halluni, si dhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, kanë lexuar dhe komentuar hadithe të ndryshme, nga përmbledhja e Imam Sujutit: “El-Xhamius-sagir”.

Aktiviteti është ndërthurrur edhe me këndimin e disa ilahive të bukura nga H. Sami Muçej, i cili, përtej moshës së thyer, ka qenë i pranishëm në këtë pasdite të begatë, me zërin dhe emocionet e tij.

I pranishëm në këtë aktivitet ka qenë edhe Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Maxhid Cungu dhe Drejtori i Zyrës së Kulturës në KMSH, z. Genti Kruja.

Në fund të këtij tubimi, për të pranishmit është shpërndarë broshura me titull: “Çfarë përfitoi bota me ardhjen e Hz. Muhammedit (a.s)”, përgatitur nga Imam Muhamed Sytari, me rastin e Mevludit të sivjetshëm.

Ditën e xhuma, më 9 janar 2015, nëpërmjet ekranit të Tv1 Channel, Myftinia Shkodër organizoi një bashkëbisedim fetar, ku pyetjeve të përgatitura nga teologu Arben Halluni, iu përgjigj thirrësi islam Lavdrim Hamja.

Në qendër të këtij emisioni special ishte përkujtimi i dërgesës profetike të Hz. Muhammedit (a.s), misionit dhe porosive të tij për njerëzimin.

Thirrësi islam, Hamja foli për rëndësinë e përkujtimit të Lindjes së Hz. Muhammedit (a.s) dhe aktivitet që po zhvillon Myftinia Shkodër, në kuadër të përkujtimit të kësaj dite të shënuar, jo vetëm për besimtarët, por për mbarë njerëzimin, duke ditur se profeti Muhammed (a.s) u dërguar mëshirë për mbarët botët, siç thotë edhe Zoti (xh. sh) në Kur'an: "Ne, nuk të dërguam ty (o Muhammed), veçse mëshirë për mbarë botët".

Pyetjes se, çfarë do të thotë: "Muhammedi (a.s), mëshirë e dhuruar për gjithësinë", thirrësi islam Lavdrim Hamja iu përgjigj, se me ardhjen e Pejgamberit (a.s), bota u ndriçua, sepse e nxori njerëzimin nga errësira e adhurimit të idhujve të pajetë, për tek drita e adhurimit të një Zoti të vetëm. U mësoi njerëzve moralin e bukur dhe fisnik. I largoi

MISIONI UNIVERSAL I HZ. MUHAMMEDIT (A.S) NË TV1 CHANNEL



nga veset e ulëta shtazore, imoralitetit, dhunës, vrasjes etj.

Ai theksoi, se pasimi i profetit Muhammed (a.s) konsiston në pasimin e tij në moralin e bukur dhe virtytet e larta, sepse në këtë mënyrë quhem pasues të denjë të tij.

Ndërsa, pyetjes se si i komenton ngjarjet terroriste të ndodhura së fundmi në Francë? Thirrësi islam Hamja, iu përgjigj se Islami dënon çdo akt dhune prej kujtdo qoftë, veçanërisht dhunës në emër

të fesë. Ndërkohë, ai theksoi se liria e fjalës nuk duhet të përdhosë figurën dhe dinjitetin e askujt në botë, sepse liria e njeriut përfundon tek cënimi i lirisë së tjetrit.

Në mesazhin e tij për teleshikuesit, thirrësi islam Lavdrim Hamja bëri thirrje për një njohje më të mirë dhe më të thellë të figurës dhe personaliteti të Hz. Muhammedit (a.s) dhe se njerëzimi ka nevojë për njohjen dhe stolisjen me moralin fisnik të këtij Pejgamberi (a.s).

MYFTIU, BASHKËBISEDIM ME NJË GRUP STUDENTËSH



Ditën e dielë, më 18 janar 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, zhvilloi një bashkëbisedim të përzemërt me një grup studentësh të degëve dhe universiteteve të ndryshme shqiptare dhe jashtë vendit.

Objekt i këtij bashkëbisedimi ishte aktualiteti, realiteti i Thirrjes Islame në Shkodër, Shqipëri dhe mbarë botën, sfidat, pengesat dhe optimizmi për një të ardhme të dritshme dhe ngazëllyese për përhapjen e vlerave

islame në mbarë botën.

Në bisedën e tij të ngrohtë me studentët, Myftiu theksoi se realitetet me të cilat përballet Thirrja Islame sot në botë, nuk janë asgjë tjetër vetëm se një tërheqje vëmendje hyjnore për të gjithë njerëzimin deh muslimanët në veçanti, për t'u zgjuar nga hutimi shekullor dhe rikthimi me tërë forcat e tyre në kërkimin e dijes së dobishme dhe praktikimin e Islamit në jetën e përditshme.

Myftiu kërkoi nga studentët, që mos të harxhojnë kohën e vyer me gjëra të padobishme dhe debate të pavlera, por të angazhohen maksimalisht për t'u thelluar në dije dhe për të perfeksionuar profesionet në jetë.

Në përgjigje të pyetjeve të ndryshme të studentëve, Myftiu dha sqarime të shumta edhe rreth paqartësive dhe shpifjeve në adresë të personalitetit të Hz. Muhammedit (a.s) dhe ngjarjeve të ndryshme, që spikatën në jetën e tij. Njëkohësisht theksoi, se sikur Islami të mos kishte mbrojtje hyjnore nga Zoti i gjithësisë, nuk vazhdonim të lexonim të njëjtin Libër të shenjtë; Kur'anin, që lexohej edhe para 15 shekujsh, pas asnjë deformimi a mangësi.

Gjatë këtij bashkëbisedimi të ngrohtë, Myftiu i dhuroi studentëve edhe botimin e tij më të fundit, me rastin e përkujtimit të sivjetshëm të Lindjes së Begatë të Profetit (a.s), me titull: "Çfarë përfitoi bota me ardhjen e Hz. Muhammedit (a.s)".

“Drita Islame”

është e të gjithëve

Ndihmo që të rrezatojë me ndriçimin e saj të vërtetë



Abonohu!

Kanë filluar abonimet për vitin 2015. Vetëm 1200 lekë

Kontakt: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë

Tel/fax: + 355 4 22 30 492 | Cel: 067 30 64 871 | e-mail: info@dritaislame.al

Për më tepër kontaktoni pranë myftinisë së rrethit tuaj, medreseve, ose pranë xhamisë më të afërt.

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja
Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org